


FORMULARI 3 – TEKSTI I THIRRJES PUBLIKE



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE / MUNICIPALITY OF GJILAN / GILAN BELEDIYESI



Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport / Direkcija za Kultururu, Omladinu i Sport / Department of Culture, Youth and Sport

REFERENC-Ë:			SH. Z nr.		
CC:					
PËRMES/PREKO/THROUGH:			Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport Drejtoreshë- Deniza Limani		
NGA/OD/FROM:			DKRS		
TEMA/SUBJEKAT/ SUBJECT:			Thirrje publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve të OJQ-ve.		
Nr. I Zyrës:		Lokacioni:	Gjilan	Data:	
Br.		Lokacija:		Datum:	28.08.2020
Kancelarije:		Extencion:		Date:	
Room No:					

Thirrje publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve/programmeve të OJQ-ve Kulturë, Rini dhe Sport

1. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Gjiçanit, u bënë thirrje të gjitha organizatave joqeveritare të regjistruara në Republikën e Kosovës, programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushën e *Kulturës, Rinisë dhe Sportit* të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në *organizimin e festivaleve, manifestimeve, muzikë, botime, edukim kulturor, rini dhe sport në Komunën e Gjiçanit*.

2. OJQ-të në përputhje me këtë thirrje publike, mund të aplikojnë me projektet propozimet për organizimin e **Aktiviteve Kulturore**:

- Festivale
- Manifestime (Festave sipas kalendarit kulturor Komunal dhe Shtetëror)
- Muzikë
- Botime
- Edukim Kulturor

3. OJQ-të në përputhje me këtë thirrje publike, mund të aplikojnë me projektet - propozimet për organizimin e Aktiviteteve Rinore:

- Rritja e pjesëmarrjës së të rinjëve;
- Edukimi joformal;
- Stimulimi i ndërrmarësisë tek të rinjët;
- Edukimi dhe promovimi shëndetësor;
- Siguria e të rinjëve;
- Integrimi shoqëror, sporti, kultura dhe rekreacioni;

4. OJQ-të në përputhje me këtë thirrje publike, mund të aplikojnë me projekt- propozimet për organizimin e Aktiviteteve Sportive:

- Manifestimet tradicionale sportive (sipas kalendarit zyrtar të festave sportive);
- Promovimi dhe pjesmarrja e vullnetarëve në sport;
- Masovizimi i pjesmarrjes së qytetarëve në aktivitete rekreativo- sportive;
- Promovime sportive,
- Edukimi publik, trajnime dhe promovime të publikut për ndeshje sportive,
- Zhvillimi dhe përparimi i edukimit fizik të fëmijët në institucione parashkollore, forcimi i ndikimit të sportit në shkolla dhe universitet
- Edukimi formal dhe joformal për ngritjen e cilësisë tek klubet dhe individët;
- Përfaqësimi i sportit mbrenda dhe jashtë shtetit

5. OJQ-të, mund të aplikojnë vetëm me më së shumti 2 (dy) projekte. Periudha e zbatimit të projektit është deri në 31.12.2020

6. Vlera e përgjithshme e planifikuar e thirrjes është (100.000 Euro).

Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për çdo projekt është **500€ (Euro)**, ndërsa shuma maksimale për një projekt është **8,000€ (euro)**.

Afati për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë pune, gjegjësisht nga dt.**28.08.2020** deri më **17.09.2020**.

Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave joqeveritare në Republikën e Kosovës, e të cilat veprojnë në komunën e Gjilanit së paku një vit para datës së publikimit të thirrjes publike.

DKRS do t'u kërkojë organizatave fituese që ti përshtatin aktivitetet e projekteve të tyre konform situatës aktuale duke respektuar rregullat e rekomandimet nga Instituti i Shëndetit Publik të Kosovës.

Procesi i pranimi, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendarit tregues i zbatimit të thirrjes, janë të detajuara në Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike.

thirrjes publike. Para nënshkrimit të kontratës, OJQ duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe prova se OJQ-ja ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara, nëse është e aplikueshme. OJQ-të që nuk kanë të përmbyllura projektet e kaluara të mbështetura nga DKRS dhe nuk kanë dorëzuar raportet e tyre financiare e narrative nuk mund të përkrahen.

Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën elektronike: **dkrs.gjilan@rks-gov.net**

Projektet e propozuara duhet tu përmbahen datave të implelementimit të aktiviteteve nga muaji Tetor – Dhjetor 2020 dhe duhet të mbyllen mrenda këtij viti përfshirë raportet narrative dhe financiare të tyre.

Projektet duhet përmbajnë projektin ideor të konceptuar me shtjellimin e idesë dhe planin për realizim;

-Specifikacionet financiare të detajuara;

-Të ofrojnë ide kreative dhe të jenë të pa publikuara më parë.

-Të ofrojnë projekte të specifikuara dhe përshkrimin e përgjithshëm të projektit.

-Të ofrojnë dëshmi për përvojat e mëhershme në implementimin e projekteve në kulturë, rini dhe sporte dhe një letër motivimi jo më shumë se 100 fjalë.

Projektet duhet tu përmbahen këtyre linajve të shumave/vlerave të përgjithshme, sipas miratimit të projektit të përgjithshëm nga K.K Gjilan për financimin e OJQ-ve në thirrjen publike për vitin 2020.

Lista e dokumenteve të thirrjes publike

Për OJQ-të:

- Çertifikata e Regjistrimit të OJQ-së;
- Çertifikata e Nr. fiskal;
- Vërtetimi/Konfirmimi i llogarisë bankare të OJQ-së (nuk pranohet kopje e kartelës bankare);
- Kopjen e letërnjoftimit/pasaportës të përfaqësuesit të OJQ-së